

Kuvendi ka të fshehtë vetëm “Kutinë”

[Gazeta Shqiptare, 12.3.2006]

Kryetarja e Kuvendit na zhgënjeu: nuk bëri “kthimin e bukur amerikan”, por na dha spektaklin e vjetër: ulurimat e zakonshme, me zë e me xheste: nuk kishte parë ajo Amerikën, por e kishte parë Amerika atë. Është e pasinqertë kur me gishtin që të shponte sytë uluret “ju, ... ju, ...”, në vend që të thotë “ju dhe na, ... ju dhe na”—a nuk ishte ajo vetë nënkryetarja e Kuvendit në kohën e “ju-ve të saj”, kohë kur veç me votimin e fshehtë të deputetëve nuk u mor, as ajo personalisht, e askush nga të sajët me në krye kryeministrin aktual! Qe qesharake, apo tinëzare, kur rekomandoi të merret eksperiencia e votimit të fshehtë në “Kongresin e SHBA”, duke e ditur se në Kongresin amerikan nuk ka votim të fshehtë?!

Në kushtet e dhunimit të publikut, që nuk po frenohet as nga normat më elementare të moralit, del nevojë të bëhen sqarime gazetareske, edhe për çështje të bezdisshme, si procedurat e votimit.

Votimi i fshehtë me kuti

Shtypen fletët e votimit, sipas alternativës që votohet, p.sh., nëse votohet për t’u hequr kryetarja e Kuvendit tonë, fleta e votimit ka tre vende ku do të vihet kryqi: “pro”, “kundra” dhe “abstenim”. Deputeti merr fletën e votimit nga komisioni i votimit, firmos në listën e votuesve, hyn në kabinën (apo dhomën) e votimit të fshehtë, vë kryqin në fletën e votimit, e palos fletën e votimit, dhe shkon dhe e hedh në kutinë e fletëve të votimit. Pasi e ka kryer këtë procedurë, secili deputet që do të votoje, kutia e votimit hapet në sytë e gjithë deputetëve, po aty në sallën e seancave. Edhe numërimi i votave bëhet po aty, në sytë e të gjithëve. Gjatë të gjithë procesit të votimit, jo vetëm që nuk dihet se si ka votuar secili deputet, por nuk dihet as dhe rezultati i votimit, deri në përfundimin e të gjithë procesit, deri sa të mbarojë numërimi i të gjitha votave.

Votimi i fshehtë me mënyrën elektronike

Para secilit deputet në tavolinën ku ulet në seancë në Kuvendin tonë, ka një terminal të impjantit elektronik, një pult individual me tre butona, “pro”, “kundra” dhe “abstenim”. Këta butona funksionojnë nëse deputeti futë një kartë identifikimi që përmban kodin e tij. Përballë të gjithë deputetëve, në sallë e madhe të Kuvendit, ndodhet afishuesi i impjantit elektronik, një Tabelë qendrore ku janë të shënuar emrat e të gjithë deputetëve (140 emra). Pranë çdo emri në tabelë, ndizet një dritë, mjafton që deputeti të shtypë cilindro nga tre butonat në pultin individual. Kjo dritë tregon se deputeti votoi. Gjatë procesit të votimit, vazhdimisht del rezultati gjithsej i votimit, kaq “pro”, kaq “kundra” dhe kaq “abstenim”, natyrisht pa treguar se si ka votuar secili deputet.

Ku qëndrojnë të metat e mënyrës tonë elektronike:

1—Ka mundësi të shihet se cilin buton shtyp deputeti, kjo duke parë lëvizjet e gishtave të deputetit. Për të mos parë dot lëvizjen e gishtave të deputetit, këto ditë u mbuluan pulcet individuale me ca parete, gjë që shpresohet se vështirëson që të shihen gishtat e deputetit.

2—Ka mundësi të shihet ndryshimi i rezultatit në tabelë, në momentin që deputeti shtyp butonin. Pra, p.sh. nëse në momentin e shtypjes së butonit, të tabelën qëndrore rritet numri që tregon votat e dhëna gjithësej “kundra”, kjo tregon se deputeti ka votuar kundra. Në fillim të votimit, kur të gjithë votojnë menjëherë, është e vështirë të kapet sa shpjeguam, por është fare e lehtë kur votimi i deputetëve zhvillohet ngadalë, siç është rasti i votimit të deputetëve që votojnë vonë.

3—Duke ditur këto dy mënyrat e mësipërme të dekonspirimit të votës, shpesh deputetët servilë, e dekonspironë vetë votën e tyre (me dëshirë ose të kërcënuar), qoftë duke bërë shtypje butoni në mënyrë që të tjerët t’i shohin se cilin buton po shtypin, qoftë duke votuar pak vonë, kështu që kolegët i shohin se si po votojnë “sipas porosisë së kapos”.

4—Flitet edhe se ka mundësi që të nxirret nga impjanti i kompjuterit, një listë se si kanë votuar njerëzit, por për këtë nuk po ndjehet as PD e as PS (!)—a mos janë të dyja mëkatore, dhe kanë një marrëveshje, në heshtje, për të mos folur?! I bëjmë thirrje individëve që kanë dijeni konkrete të prononcohen publikisht, me që me këtë do të jepnin një ndihmesë të madhe në pastrimin e demokracisë sonë nga korrupsioni politik, që është më i rrezikshëm se korrupsioni ekonomik: është më e dëmshme të vjedhësh vota, se sa të vjedhësh para.

Eksperienca e vendeve të tjera

Na rezulton se pak vende e përdorin votimin e fshehtë më mënyrën elektronike, për zgjedhjen ose shkarkimin e personave, sidomos në parlamentet si yni, që nuk kanë aq shumë deputete. Problemi kryesorë është: “votimi me mënyrë elektronike duhet të përdoret vetëm nëse është i sigurtë dhe pa difekte”—impianti Kuvendit tonë, nuk plotëson asnjë nga këto kërkesa! Po marrim si shembull Lituaninë, që ka një parlament sa yni (141 deputetë), që si ne, është një shtet i vogël dhe ka një të kaluar komuniste, por që tashmë është anëtar i Bashkimit Evropian. **Në Lituani, votimi i fshehtë në parlamentin e tyre (Seima) bëhet vetëm me “kuti” dhe jo “në mënyrë elektronike”.** E pra, Lituania ka një traditë në elektronikë, me mijra herë më të madhe se ne; ka korrupsion politik, shumë më të vogël se ne!

Po, le të krahasojmë se çfarë shkruhet në Rregulloren e parlamentit të Lituanisë, dhe në atë të Kuvendit tonë.

Seima e Lituanisë: *“Votimi i fshehtë bëhet me kuti ... Gjatë kohës që bëhet votimi i fshehtë, nuk bëhet seancë. Fletët e votimit vulosen dhe shpërndahen nga komisioni i numërimit të votave. Kur deputeti merr fletën e votimit, duhet të firmosë procesverbalin e fletëve të votimit të përgatitura. Duhet të ketë një kabinë të votimit të fshehtë si dhe një kuti të fletëve të votimit, në sallën ku kryhet votimi. Kutia e fletëve të votimit duhet të vendoset në mënyrë të tillë, që për t’iu afruar asaj, deputeti që po voton, duhet që të detyrohet të kalojë nëpër kabinën e votimit të fshehtë.”*

Kuvendi ynë: *“Votimi i fshehtë bëhet duke hedhur në kutinë e votimit fletën e votimit ose në mënyrë elektronike”. Vetëm e vetëm kaq, e asnjë fjalë më tepër.*

Sa lakonikë që jemi, kur na intereson t'i lëmë gjërat e errëta!

Bëjmë mirë ta shuajmë urgjentisht nga rregullorja, togfjalëshin “ose në mënyrë elektronike”, deri për një kohë të pacaktuar.

Për votimin e fshehtë të deputetëve nuk mund të merret shembull nga SHBA, sepse kongresmenët (deputetët) amerikanë votojnë haptas, e gjithë elektronika e Kongresit amerikan synon jo të fshehtë votën e tyre, por përkundrazi ta pasqyrojë sa më qartë e dukshëm: votuesit amerikanë duan të dinë si votoi kongresmeni i tyre! Por kjo është temë tjetër, ne të mbetemi tek sistemi ynë, tek Kushtetuta jonë, tek sigurimi i votimit të fshehtë për deputetët tanë!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 11.3.2006